

A - Lutjes për punësim tek dy ose më shumë punëdhënës (paragrafi i katërt i nenit 19. të Ligjit për punësim, vetëpunësim dhe punë të huajve) duhet bashkëlidhur:

- kontratën mbi punësimin, të nënshkruar nga ana e punëdhënësit;
- dëshminë mbi arsimimin e lartë adekuat të të huajit përkatësisht të plotësimit të kushteve tjera, të cilat i kërkon punëdhënësi (paragrafi i shtatë, tetë ose nëntë i nenit 12. të Ligjit për punësim, vetëpunësim dhe punë të huajve);
- marrëveshjen midis punëdhënësit të ri, të huajit dhe punëdhënësit tek i cili i huaji tashmë është i punësuar;
- deklaratën e nënshkruar të punëdhënësit ose garanton strehimin e të huajit ose jo.

Në rastin e punëdhënësit, i cili është i regjistruar më pak se gjashtë muaj, duhet që lutjes t'ia bashkëlidhë deklaratën e punëdhënësit si dhe dëshminë lidhur me atë, se para depozitimit të lutjes për lëshimin e lejes unike për shkak të punësimit të huajit ka investuar së paku 50.000 euro në veprimtarinë, brenda kornizës të së cilës i huaji do bëjë punën (paragrafi i tretë i nenit 27. i Ligjit për punësim, vetëpunësim dhe punë të huajve).

Në procedurën e dhënies së pëlqimit tek miratimi me shkrim për punësim tek dy ose më shumë punëdhënës Enti i Republikës së Sllovenisë për punësim sipas detyrës zyrtare do ti siguroi të dhënat:

- se nga dita e përfshirjes në sigurime sociale në bazë të punësimit të parë ka kaluar së paku një muaj;
- se në evidencën e personave të papunësuar nuk ka person adekuat të papunësuar;
- se punëdhënësi është i regjistruar adekuat ose i regjistruar në regjistrin e ekonomisë bujqësore përkatësisht në regjistrin afarist për kryerjen e veprimtarisë, brenda kornizës të së cilës i huaji do ta kryej punën;
- se punëdhënësi nuk është në procedurën e likuidimit ose falimentimit;
- se punëdhënësi zhvillon afarizëm aktiv;
- se punëdhënësi për të hyrat nga marrëdhënia e punës për gjashtë muajt e fundit para muajit të depozitimit të lutjes ose për kohën e afarizmit, nëse ky është më i shkurtë se gjashtë muaj, ka propozuar përllogaritjet e tërheqjes tatimore për të hyra nga marrëdhënia e punës, nëse ka punësuar punëtorë, si dhe nuk ka të pa paguara detyrime tatimore të skaduara.

A1 I huaji, i cili do të punësohet në ndërmarrje, të regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve me vlerë të shtuar të lartë ose në regjistrin e ndërmarrjeve startuese inovative (paragrafi i dytë i nenit 16. të Ligjit për punësim, vetëpunësim dhe punë të huajve):

- kontratën mbi punësimin, të nënshkruar nga ana e punëdhënësit, ku të huajit është garantuar paga së paku në lartësi të pagës bruto mujore mesatare në Republikën e Sllovenisë, të publikuar së fundmi në Gazetën zyrtare të Republikës së Sllovenisë;
- dëshminë mbi arsimimin adekuat ose kualifikimin e profesionit të huajit përkatësisht mbi plotësimin e kushteve tjera, të cilat i kërkon punëdhënësi;
- deklaratën e nënshkruar të punëdhënësit ose garanton strehimin e të huajit ose jo.

Në procedurën e dhënies së pëlqimit tek miratimi me shkrim për shkak të

punësimit tek dy ose më shumë të punëdhënës Enti i Republikës së Sllovenisë për punësim sipas detyrës zyrtare do ti siguroi të dhënat në vijim:

- se në evidencën e personave të papunësuar nuk ka person adekuat të papunësuar;
- se punëdhënësi është i regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve me vlerë të shtuar të lartë ose në regjistrin e ndërmarrjeve inovative startuese;
- se nuk është shfrytëzuar kuota, me të cilën kufizohet numri i të huajve në tregun e punës.

Informata lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale:

- të dhënat personale nga formulari për qëllim të lëshimit të lejes për qëndrim përpunohen në ujdi me nenin 93. të Ligjit për të huajt;
- organi ka të drejtë që të përfitoi edhe të dhëna tjera, nëse kjo është në interesin tuaj dhe se për këtë e keni dhënë pëlqimin ose nëse kjo është e lejuar me ligj, pëlqimin mund ta revokoni kurdoherë pranë organit;
- nëse për këtë janë plotësuar kushtet e parashkuara, keni të drejtë ndaj informimit me të dhënat tuaja personale, të drejtën ndaj përkufizimit të përpunimit dhe të drejtën ndaj kundërshtimit të përpunimit;
- keni të drejtë që të verifikoni saktësinë e të dhënave tuaja personale, të shënuara në lejen për qëndrim, dhe të drejtën që të kërkonti ndryshimin e tyre ose, nëse për këtë janë të plotësuar kushtet e parashkuara, fshirjen e tyre;
- menaxhuesi i ruan të dhënat tuaja në ujdi me nenin 115. të Ligjit për të huajt;
- kontakti i personit të autorizuar të menaxhuesit për mbrojtjen e të dhënave personale në Ministrinë e punëve të brendshme: posta elektronike: dpo.mnz@gov.si;
- nëse jeni të mendimit, se të dhënat tuaja po përpunohen joligjshëm, mund të ushtroni ankesë pranë Autorizuesit të informimit.